



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

Nr. 3850/prot.

Pogradec më, 23.10.2025

**PROJEKT- VENDIM**

NR \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 56 DATË 19.06.2023 “PËR KRIJIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC.**

Në mbështetje të shkronjës “a” të nenit 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen Vendore” si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me nr 40 datë 05.03.2020 ,

**VENDOSI:**

1.Të miratojë një shtesë në emërtimin e Komisionit të Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Të Drejtave të Njeriut, për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European , si më poshtë:

1.6 Komisioni I Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European të ndrshojë emërtimin në Komisioni I Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, për Marrëdhëniet me jashte dhe Integrimin European , Migracionin dhe Diasporën.

2.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari I Bashkisë, Sekretari I Këshillit dhe Komisionet

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE  
SEKTORI I PËRFSHIRJES SOCIALE, BARAZISË GJINORE DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE

Pogradec, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2025

## RELACION

E nderuar Kryetare e Këshillit!  
Të nderuar Këshilltarë!

Këshilli bashkiak ka miratuar me vendim nr. 29, datë 23.03.2025 Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën për vitet 2025-2030 për Bashkinë Pogradec, i cili u hartua nga Drejtoria e Shërbimit Social, me asistencën e GIZ Albania.

Migracioni dhe diaspora kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në Bashkinë e Pogradecit. Me ligjin 38/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", neni 29/1, gërma "a" u parashikua krijimi i strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Bashkia Pogradec prej vitit 2023 ka integruar në strukturën organizative një pozicion të ri pune për Migracionin dhe Diasporën, me qëllim që të forcohen lidhjet me komunitetin e migracionit dhe diasporës, komunitet që edhe pse larg, mbetet gjithmonë pjesë e qytetit të Pogradecit.

Ky është një hap drejt përfshirjes së tyre në jetën e komunitetit lokal pasi mund të ndajnë idetë e tyre, të sugjerojnë, dhe të japin kontribut të rëndësishëm për çështje që lidhen me Pogradecin. Duam të ndërtojmë një urë bashkëpunimi të qëndrueshme, ku përvojat, njohuritë dhe rrjetet që diaspora dhe migracioni ka krijuar jashtë vendit të kthehen në vlerë për zhvillimin e qytetit.

Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon të integrojë këto aspekte në politikat dhe strategjitë vendore duke ofruar një platformë bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm midis komunitetit lokal dhe diasporës së Pogradecit.

Ky plan synon, gjithashtu, riintegrimin e emigrantëve që kthehen, nxitjen e investimeve të diasporës dhe krijimin e mekanizmave për përfshirjen e tyre në vendimarrje dhe zhvillimin e projekteve lokale.

Procesi i hartimit të planit është bazuar në Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024-2030, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025, Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030, Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen vendore 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

### Qëllimi kryesor:

Të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinuar çështjeve të migracionit dhe diasporës, duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal.

Fushat e përcaktuara në Planin Vendor janë:



1. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.

Objektivat:

- Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe rritja e aftësive të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit dhe diasporës
- Ndërtimi i partneriteteve afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e kthyer

2. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare

Objektivat:

- Edukimi dhe informimi i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore
- Sigurimi i shërbimeve sociale për përfshirjen dhe riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës

3. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit lokal

Objektivat:

- Njohja dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantët
- Sigurimi i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti i diasporës

Prandaj, kërkojmë nga ana juaj krijimin e komisionit në Këshillin bashkiak për të realizuar objektivat e sipërsënuara dhe prioritetet e Bashkisë në lidhje me Migracionin dhe Diasporën.

Ju Faleminderit!

Konceptoi: Klea Agolli, Specialiste për migracionin dhe diasporën

Pranoi: Elda Pengu, Përgjegjëse Sektori

K.A./

DEJTOR  
Ivana CAPOLLARI